



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Ekonomisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Ekonomisë (ME), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ministria nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive në PFV, për shkak se vlera e pasurive ishte mbivlerësuar për 6,996,517€ dhe nënvlerësuar për 181,345€. Këto mangësi përfshijnë mosbartjen e pronësisë për projektet e përfunduara të efijencës së energjisë te institucionet përfituese, raportimin jo të saktë të pasurive, si dhe mosregjistrimin e disa pasurive në regjistër.
- A2 Ministria nuk kishte trajtuar dhe regjistruar siç duhet pagesat që ndërlidhen me investimet kapitale, në përputhje me kërkesat për kapitalizimin e tyre, si rezultat vlera e pasurive ishte e nënvlerësuar për 627,643€.
- B1 Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2025 kishte paguar/shpenzuar nga kategoria ekonomike jo adekuate vlerën prej 223,470€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ME kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Ekonomisë.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Ekonomisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Ekonomisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat kryesore që kërkojnë më tepër fokus përfshijnë: klasifikimin e saktë të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike përkatëse, evidentimin e pasurive dhe menaxhimin e tyre në përputhje me rregullat e përcaktuara. Po ashtu, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet efektivitetit të proceseve të prokurimit dhe auditimit të brendshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesë rekomandime, prej tyre tri janë rekomandime të reja dhe dy të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i pasurisë në PFV

##### Gjetja

Neni 13 i Rregullores MF-nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton që: "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj". Ndërsa, sipas nenit 24, pikës 2, raportimi dhe paraqitja e pasurive në pasqyrat vjetore financiare duhet të bëhet nga: SIMFK-ja për pasuritë mbi 1,000€ dhe afat të përdorimit mbi një vit dhe E- pasuria për pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe afat të përdorimit mbi një vit dhe stoqet.

Ministria nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive në PFV të vitit 2025 dhe si rezultat vlera e pasurive ishte mbivlerësuar për 6,996,517€ dhe nënvlerësuar për 181,345€. Mangësitë e identifikuara janë si në vijim:

- Ministria e Ekonomisë kishte mbështetur projektin "Zbatimi i Masave të Eficiencës së Energjisë në objektet në pronësi të Komunave" me mjete financiare në vlerë prej 4,671,457€. Projekti kishte përfunduar në vitin 2024 dhe 22 komuna kishin përfituar investime në objekte të ndryshme. Megjithatë, edhe pse ministria kishte nënshkruar marrëveshje me 19 komuna për bartjen e pronësisë së aseteve të komunat përkatëse, këto pasuri kishin vazhduar të mbaheshin në regjistrat e ministrisë dhe ishin raportuar në PFV si investime në vijim duke e mbivlerësuar vlerën e pasurive. Ndërsa, për tri komuna deri më 31.12.2025 nuk ishin nënshkruar ende marrëveshjet për bartjen e pronësisë së aseteve nga ministria te komunat përfituese edhe për

- kundër kërkesës së bërë nga ME gjatë vitit 2025.
- Po ashtu, projekti “Implementimi i Masave të Efiçencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtitshme në 12 objekte publike të nivelit qendror”, në vlerë 2,002,464€ edhe pse kishte përfunduar në fund të vitit 2024, ministria nuk kishte bërë bartjen e pronësisë për këto pasuri të institucionet përkatëse. Pra, në regjistrat e pasurisë së ministrisë ky projekt ishte regjistruar si investime në vijim në shumë prej 1,919,022€ duke e mbivlerësuar regjistrin e pasurive. Për më shumë, është vërejtur se projekti nuk ishte regjistruar në vlerën e saktë për shkak se shuma prej 83,442€ nuk ishte regjistruar fare duke nënvlerësuar regjistrin e pasurive.
  - Përveç kësaj, kemi identifikuar se Ministria nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive prej 406,038€ në PFV për faktin se këto ishin pasuri kapitale dhe përveç që i kishte raportuar te regjistri i pasurive mbi 1,000€, ato i kishte raportuar edhe në regjistrin e pasurive nën 1,000€. Pra, vlera e pasurive është mbivlerësuar
  - Gjithashtu, në regjistrin e pasurive kapitale ishte evidentuar një pasuri me vlerë neto 0€, edhe pse sipas dokumenteve përkatëse ajo kishte vlerë të mbetur 23,791€. Po ashtu, një pasuri tjetër nuk ishte përfshirë në regjistrin e pasurive kapitale në vlerë 74,112€ e blerë në vitin 2018 duke rezultuar në prezantim jo të saktë të pasurive kapitale. Si rrjedhojë, pasuritë ishin nënvlerësuar.

Mos trajtimi i investimeve në vijim kishte ndodhur për shkak të mungesës së koordinimit të veprimeve konkrete të ME dhe komunave përkatëse. Gjithashtu, mangësitë në raportimin e pasurive lidhen me mungesën e kontrollit të brendshëm dhe të trajnimeve për zyrtarët e pasurisë në përdorimin e sistemit e-Pasuria.

#### **Ndikimi**

Mangësitë e identifikuar ndikojnë në prezantim jo të plotë dhe të saktë të pasurive në PFV. Njëkohësisht, kjo rrit rrezikun e mosregjistrimit në kohë nga institucionet përfituese dhe krijon mospërputhje ndërmjet regjistrave. Si pasojë, dobësohet kontrolli mbi pasurinë publike dhe vështirësohet përcaktimi i përgjegjësisë për menaxhimin e saj.

#### **Rekomandimi A1**

Ministrja duhet të sigurojë që përmes zyrtarëve përgjegjës të bëjë analizë të plotë të investimeve në vijim, të identifikojë dhe çregjistrojë pasuritë e dorëzuara, si dhe për pasuritë për të cilat procesi i bartjes së pronësisë ende nuk kishte ndodhur, të ndërmerren veprime për finalizimin e këtij procesi. Po ashtu, duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të siguruar regjistrim dhe raportim të saktë të pasurive në regjistra dhe PFV.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Mos përfshirja e pagesave kapitale në regjistrin e pasurive**

#### **Gjetja**

Neni 6 i Udhëzimit Administrativ MF - Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale përcakton kriteret e përgjithshme për klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale. Sipas pikave 1.3.4 dhe 1.3.6 të këtij neni: “Shpenzimet e instalimit dhe montimit gjatë përgatitjes së asetit për përdorim, si dhe shpenzimet profesionale që ndërlidhen me dizajnimin, zhvillimin, ndërtimin ose lëshimin e asetit në përdorim, klasifikohen si shpenzime kapitale”.

Ministria nuk kishte trajtuar dhe regjistruar siç duhet pagesat që ndërlidhen me investimet kapitale, në përputhje me kërkesat për kapitalizimin e tyre.

Mangësitë janë si në vijim:

- Shuma prej 404,173€ nuk ishte trajtuar si pasuri kapitale dhe nuk është përfshirë në regjistrin e pasurive dhe si rrjedhojë vlera e pasurive ishte nënvlerësuar. Kjo shumë ka të bëjë me dizajnimin e detajuar të planit për rrjet dhe infrastrukturë të rrjetit, si dhe për kabllimin dhe lidhjen e pajisjeve, të realizuara në kuadër të projektit “Instalimi i rrjetit të brendshëm, pajisjeve dhe lidhjes së internetit me shkollat”.
- Po ashtu, pagesa e avancit në vlerë prej 223,470€ për “Shërbime të Konsulencës dhe Mbikëqyrjen e Punimeve të Projektit të Menaxhimit të Ujërave të Ndotura të Prishtinës” nuk ishte regjistruar si investim në vijim dhe si rrjedhojë regjistri i pasurive ishte nënvlerësuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së vëmendjes gjatë trajtimit të projekteve kapitale dhe mungesës së kontrolleve efektive në procesin e regjistrimit të pasurive.

**Ndikimi** Mangësitë e identifikuar kanë ndikuar në nënvlerësim të pasurive kapitale dhe paraqitje jo të saktë të pasqyrave financiare.

**Rekomandimi A2** Ministria duhet të sigurojë zbatimin e plotë të kërkesave për kapitalizimin e shpenzimeve në projektet kapitale, si dhe forcimin e kontrolleve të brendshme për të garantuar regjistrim të saktë dhe të plotë të pasurive në regjistrin përkatës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve**

**Gjetja** Sipas nenit 18, pika 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë të regjistruara në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, sipas nenit 6 pika 1.3.6 e Udhëzimit Administrativ MF - nr. 04/2019 Shpenzimet profesionale që ndërlidhen me dizajnimin, zhvillimin, ndërtimin ose lëshimin e asetit në përdorim klasifikohen si shpenzime të projekteve kapitale.

ME kishte ekzekutuar një pagesë në vlerë prej 223,470€ nga kategoria mallra dhe shërbime, të cilat për nga natyra i përkasin kategorisë së investimeve kapitale. Këto shpenzime ishin për projektin “Shërbime të Konsulencës, Mbikëqyrjen e Punimeve të Projektit të Menaxhimit të Ujërave të Ndotura të Prishtinës” dhe ndërlidhen me Kompaninë Rajonale të Ujësjetës Prishtina.

Kjo kishte ndodhur për shkak se projekti në fazën e planifikimit të buxhetit nuk ishte planifikuar në kategorinë e investimeve kapitale por ishte marr si i mirëqenë nga kërkesa e KRU Prishtina. Pra, projekti nuk ishte analizuar mjaftueshëm lidhur me shpenzimet të cilat mund të kapitalizohen.

**Ndikimi** Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka rezultuar në mbivlerësim të shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime si dhe nënvlerësim të shpenzimeve kapitale.

**Rekomandimi B1** Ministria duhet të sigurojë që procesit të planifikimit të buxhetit ti paraprijë një analizë e projekteve në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet

adekuate të buxhetit në mënyrë që shpenzimet të regjistrohen në kode adekuate.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2025 ishte 5,715,329€, prej tyre ishin shpenzuar 1,486,863€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese tjera, shërbime për anëtarësim si dhe sigurimi i ndërtesave.

#### Çështja A3 - Mangësi në zhvillimin e procedurës së prokurimit për shërbime të veçanta

**Gjetja** Neni 27.7 i Rregullores për Prokurim nr. 001/2022 me plotësim ndryshime ndër të tjera, përcakton se: kur bëhet dhënia e kontratës në bazë të kriterit “tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, dosja e tenderit dhe, nëse aplikohet, njoftimi për kontratë duhet të deklarojë të gjitha kriteret (në një mënyrë objektive dhe të matshme) që aplikohet në procesin e dhënies, dhënia e peshëve relative (në kushte monetare) të përcaktuara për secilin kriter. Ato duhet të para-vendosen dhe të bëhen të ditura për tenderuesit. Po ashtu, sipas nenit 57.17, pikët totale do të fitohen duke bashkuar pikët teknike dhe financiare. Notat e “kostos” duhet të përzgjedhen duke marr parasysh ndërlikueshmerinë e objektit të kontratës që duhet dhënë si dhe rëndësinë përkatëse të cilësisë. Rezultati i peshuar i propozimit financiar duhet të specifikohet në Dosje të Tenderit, dhe mund të jetë deri në 30 pikë.

Në procedurën e prokurimit (dosjen e tenderit) për “Shërbime të veçanta - Angazhimi i pesë ekspertëve konsulentë” kemi identifikuar se në kuadër të kërkesave dhe kriterëve të vlerësimit për dhënien e kontratës me poentim, janë përcaktuar kriterë si: përvojë pune prej tre vitesh dhe posedim të diplomës. Megjithatë për këto kriterë nuk janë definuar qartë parametrat matës për ndarjen e pikëve me nivele të ndryshme të kualifikimit, përvojës dhe cilësisë së metodologjisë së punës, si dhe mungojnë intervalet e pikëzimit dhe elementet konkrete të vlerësimit, çka pamundëson një vlerësim të krahasueshëm dhe objektiv të ofertave.

Gjithashtu, poentimi për çmimin ishte caktuar 40 pikë, në vend të 30 pikëve siç parashihet me rregullore. Ministria kishte lidhur kontratë për “Angazhimin e pesë Ekspertëve Konsulentë”<sup>1</sup> në vlerë prej 69,762€.

Mangësitë e identifikuar ishin si rezultat i mungesës së vëmendjes se duhur nga zyra e prokurimit si dhe kontroleve të brendshme jo të mjaftueshme.

**Ndikimi** Mangësitë e tilla mund të ndikojnë që në rastet e tjera të aplikimit të procedurës për shërbime të veçanta, procesi i vlerësimit të ofertave të mos vlerësohet drejtë dhe për pasojë mund të ndikoj që personeli i përzgjedhur të mos ketë performancën e duhur gjatë realizimit të projektit.

**Rekomandimi A3** Ministrja duhet të sigurojë forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Zyrën e Prokurimit, në mënyrë që kriteret të jenë të qarta, të matshme dhe të zbatohen gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.2.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Ministria e Ekonomisë ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB). Kjo njësi përbëhet nga tre auditorë (Drejtori dhe dy auditorë).

### Çështja B2 - Mangësi në planifikimin e auditimit të brendshëm dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit

#### Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, përkatësisht, neni 17 përcakton se plani i auditimit të brendshëm duhet të bazohet në vlerësimin e rrezikut dhe të jetë në përputhje me objektivat e institucionit. Tutje, neni 23 udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për funksionin e auditimit të brendshëm duhet të miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm dhe i dorëzon në Njësinë Qendrore Harmonizuese, më së largu deri më 31 dhjetor të vitit fiskal. Po ashtu edhe Udhëzim Administrativ MF- Nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik përcakton, themelimin e Komitetit të Auditimit, përbërjen e komitetit, rolin dhe përgjegjësitë si dhe takimet e komitetit të auditimit.

ME nuk kishte aprovuar planin strategjik (2025-2027) dhe planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2025 sipas afatit të përcaktuar ligjor. Këto dokumente ishin aprovuar në prill të vitit 2025 nga kryesuesi i komitetit të auditimit, i cili nga data 15 mars 2025 ishte pa mandat.

Komiteti nuk ishte në përbërje të plotë deri më 04.11.2025 si rrjedhojë, nuk kishte ushtruar rolin dhe funksionin e tij në ME.

Gjithashtu, Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kishte siguruar harmonizim të Planit Vjetor me Planin Strategjik të Auditimit. Prej tetë auditimeve të parapara në planin strategjik për vitin 2025 (gjashtë me rrezik të lartë dhe dy me rrezik të mesëm), në planin vjetor ishin përfshirë vetëm tre auditime me rrezik të lartë dhe një me kërkesë. Për më tepër, NJAB gjatë vitit 2025 kishte përfunduar dy auditime, mirëpo vetëm njëri prej tyre ishte shqyrtuar nga Komiteti i Auditimit. Vlen të theksohet se NJAB kishte kryer edhe gjashtë raporte të auditimit sipas kërkesës së menaxhementit ku fokus i auditimit ishte përmbushja e hapit të reformës.

Mangësitë e identifikuar janë rezultat i planifikimit jo të duhur të auditimit të brendshëm dhe moskoordinimit në harmonizimin e planit vjetor me objektivat strategjike. Po ashtu, shkaku i mosfunksionimit të Komitetit të Auditimit lidhet me mungesën e veprimeve në kohë për emërimin e mandatit të anëtarëve të tij.

#### Ndikimi

Mos përfshirja e plotë e fushave me rrezik të lartë në planin e auditimit si dhe niveli i ulët i përmbushjes së planit vjetor ndikon në uljen e efektivitetit të funksionit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, mungesa e funksionimit të plotë të Komitetit të Auditimit ka ndikuar në dobësimin e mbikëqyrjes dhe mbështetjes së procesit të auditimit të brendshëm, si dhe në vonesa në marrjen e vendimeve dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe vjetore.

#### Rekomandimi B2

Ministrja duhet të sigurojë që në planin vjetor të auditimit të përfshihen dhe realizohen fushat me rrezik të lartë. Po ashtu, duhet të siguroj funksionimin e rregullt të Komitetit të Auditimit përmes përzgjedhjes me kohë të

anëtarëve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>40,285,294</b>	<b>38,205,452</b>	<b>29,080,400</b>	<b>56,042,182</b>	<b>57,655,068</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	29,565,726	27,485,884	25,979,275	48,746,662	51,933,772
Financimi përmes huamarrjes	4,769,568	4,769,568	711,125	4,370,793	5,577,011
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	5,950,000	5,950,000	2,390,000	2,924,726	144,285

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 2,079,841€. Ky zvogëlim është si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë për kursim dhe ndarje.

Në vitin 2025 ME ka shpenzuar 29,080,400€ apo 76% të buxhetit përfundimtar, derisa në vitin paraprak niveli i realizimit ishte 73%.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>40,285,294</b>	<b>38,205,452</b>	<b>29,080,400</b>	<b>56,042,182</b>	<b>57,655,068</b>
Pagat dhe mëditjet	1,776,496	1,546,700	1,546,700	1,476,439	1,383,381
Mallrat dhe shërbimet	6,782,034	5,715,329	1,486,863	3,106,150	2,012,538
Komunalitë	23,130	17,350	12,593	16,875	13,342
Subvencionet dhe transferet	22,903,634	23,976,239	22,726,420	46,207,094	50,990,756
Investimet Kapitale	8,800,000	6,949,834	3,307,824	5,235,623	3,255,051

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë si më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 229,795€, si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Shpenzimi në këtë kategori ishte 100%.


Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 1,066,705€, gjithashtu si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Shkalla e realizimit në këtë kategori ishte vetëm 26%, kryesisht për shkak të progresit të ulët financiar në shpenzimin e fondeve nga huamarrja për projektet e financuara përmes klauzolës së investimeve.

Buxheti final për shpenzime komunale, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 5,780€, si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Shpenzimi në këtë kategori ishte 72%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte rritur për 1,072,604€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë për zbatimin e masave 4 dhe 5 të Planit të veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik. Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e subvencioneve është realizuar ndaj MCA-Kosova në shumë rreth 12 milionë euro, bazuar në obligimet që rrjedhin nga marrëveshja e ratifikuar në Kuvend për Projektin për Ruajtjen e Energjisë (Energy Storage Project) si projekt strategjik i Kosovës si dhe për mbështetjen financiare për ndërmarrjen publike Trepça Sh.A rreth 5 milion euro dhe ndërmarrjet tjera publike. Shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 94%.

Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 1,850,166€, si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Përkundër këtij zvogëlimi, niveli i realizimit ishte vetëm 48% gjatë vitit 2025. Ky realizim i ulët ishte rezultat i planifikimit të dobët nga Ndërmarrjet Publike (NP), të cilat kanë qenë bartëse të planifikimit dhe realizimit të projekteve të financuara nga klauzola e investimeve, përfshirë impiantet për trajtimin e ujërave të zeza në komnatat e Prishtinës, Ferizajt dhe Podujevës, si dhe Projektin e Trajtimit të Ujërave të Zeza në Mitrovicë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Ministria e Ekonomisë për vitin 2025 kishte realizuar të hyra në shumë prej 338,463€. Të hyrat jo tatimore në vitin 2025 ishin në vlerë 155,401€ ndërsa pjesa tjetër, në vlerë prej 183,062€, ka të bëjë me kthimin e mjeteve financiare të paguara gabimisht gjatë vitit 2024.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>53,987</b>	<b>53,987</b>	<b>338,463</b>	<b>16,477,025</b>	<b>121,161</b>
Të hyrat jo tatimore	53,987	53,987	155,401	128,179	117,896
Të hyrat tjera	0	0	183,062	16,348,846	3,265

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të ME-së ka rezultuar në pesë rekomandime. ME kishin përgatitur Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, tri rekomandime janë zbatuar dhe dy nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj një kontroll dhe koordinim më efektiv në mes zyrës ligjore dhe avokaturës shtetërore me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informata, dhe që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Këtë vit nuk janë identifikuar mangësi sa i përket detyrimeve kontigjente.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj që janë ndërmarrë veprime konkrete në koordinim edhe me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Edhe gjatë vitit 2025 janë identifikuar keqklasifikime të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të siguroj që themelimi i komisionit të vlerësimit të ofertave të bëhet me kohë, në mënyrë që procesi i vlerësimit të përfundojë brenda afateve të përcaktuara. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse, duhet të shtohen resurset e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit dhe për të shmangur vonesat në nënshkrim të kontratave.	Gjatë vitit 2025 nuk janë identifikuar vonesa në vlerësimin e tenderëve.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalosjet në PFV të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të drejtë. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.	ME kishte marrë veprimet e nevojshme korrigjuese duke adresuar gabimet e identifikuara në vitin paraprak.	I zbatuar
5.	Auditimi i Brendshëm	Ministrja duhet të siguroj se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Po ashtu, duhet të përmbushen objektivat duke mbuluar fushat e përcaktuara në planin vjetor të auditimit.	Njab nuk ka arritur të përmbushë planin vjetor të auditimit as gjatë këtij viti. Po ashtu, Komiteti i Auditimit nuk ka qenë funksional gjatë vitit 2025, si pasojë e skadimit të mandatit të anëtarëve të tij.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Ganimete Dalloshi, Udhëheqëse e ekipit



Valbona Pllana, Anëtare e ekipit



Vjosa Hasanaj, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË E ZBATIMIT / DATE OF IMPLEMENTATION: <b>01-06-2026</b>			
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Nr. Faqeje / Br. Stranica / No. Pages		
03	47905	1	



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTERIA E EKONOMIJE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. No.	Nr. Faqeje / Br. Stranica / No. Pages	Nr. Prot. Br. Prot. No.
61	1042	01-06-26	
PRISHTINE A NO.1			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy**

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Ekonomisë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Artane Rizvanolli

Ministre në detyrë e Ekonomisë",

Data: 29/05/2026, Prishtinë



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> 1. Administrator i Sistemit Informativ të KREN 2. Inxhinier i Lartë i Sistemeve dhe Rrjeteve të KREN 3. Inxhinier i Lartë i Sistemeve të KREN 4. Konsulent për përmbajtje dhe mbështetje edukative KREN 5. Specialist Financiar në KREN
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.